



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 450/1 Prot.

Tiranë, më 13.04.2017

VENDIM

Nr. 66, datë 13/4 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

V Ë R E N:

Ankuesit,

kanë depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") përkatësisht ankesat me nr. 330 prot, nr. 331 prot, nr. 333 prot, datë 16.02.2017, ankesën nr.383 prot, datë 24.02.2017, ankesat nr. 446 prot, nr. 448 prot, nr. 449 prot, nr. 450 prot, datë 10.03.2017 me objekt, "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ndaj Autoritetit Publik "Bashkia Berat" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesit, i janë drejtuar Autoritetit Publik me kërkesat e datave 23.12.2016 dhe 19.01.2017, për pajisje me informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

Në lidhje me kërkesat datë 23.12.2016:

- 1. Një kopje të procedurës që kërkohet nga Konventa e Aarhusit lidhur me projektet që zhvillohen në territorin e Bashkisë Berat, nga momenti i marrjes së detyrës deri tani. Nëse janë zhvilluar këto procedura, një kopje të këtyre takimeve;*
- 2. Një kopje të organigramës së Bashkisë Berat me emrat e drejtorëve përkatës dhe një kopje të curriculum-vitae-s së tyre;*
- 3. Një kopje të listës së kritereve për t'u bërë administrator në njësitë bashkiake. Emrat e administratorëve dhe një kopje të curriculum-vitae-s së tyre;*
- 4. Një kopje të buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2015, realizimin e tij, shpenzimet dhe investimet e kryera, si dhe kostot operative;*

Në lidhje me kërkesat e datës 19.01.2017

- 1. Një kopje të kritereve për t'u punësuar në policinë bashkiake dhe si janë zbatuar ato në Bashkinë Berat;*
- 2. Në territorin e Bashkisë Berat pastrimin e mbetjeve e kryen shoqëri publike apo private, nëse po si quhet shoqëria të private.*

3. *Një kopje të kontratës së lidhur me shoqëritë/të private që bëjnë pastrimin e territorit nga mbetjet. Nëse ka pasur shkelje të kontratës nga shoqëria private, çfarë masash janë marrë:*
4. *Si është kryer procedura e tenderimit për shoqëritë private, nëse ka një të tillë që bën pastrimin e territorit nga mbetjet. Një kopje të kësaj procedure.*

Ankuesit pretendojnë se janë cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk janë informuar lidhur me sa kanë kërkuar dhe për këtë arsye kanë depozituar ankesë pranë Komisionerit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresat nr.333/3 Prot datë 20.02.2017, nr.383/4 Prot datë 27.02.2017, dhe nr.446/3 Prot datë 15.03.2017, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Bashkisë Berat përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datave 27.02.2017 (për kërkesën e _____), 06.03.2017 (për kërkesën e _____) dhe 23.03.2017 (për kërkesat e _____).

Koordinatorja për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, ka kthyer përgjigje me emailin e datës 06.04.2017 në tejkallim të afatit të vendosur nga Komisioneri, duke mos e përmbushur detyrimin për dhënie informacioni me arsyetimin se kërkesat nuk ishin nënshkruar nga kërkuesit dhe nuk kishin adresë të saktë banimi, e-maili apo numër telefoni.

Për shkak se ankesat i kundrejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon se pavarësisht objektit të ndryshëm që kanë, ankesat do të procedohen përmes një vendimi të vetëm administrativ.

Gjithashtu Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit (në vijim quajtur "Ligji për të Drejtën e Informimit"), ku "informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se Autoriteti Publik nuk e ka trajtuar kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj.

Sipas pikës 4 të nenit 15, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150 000 deri në 300 000 lekë.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në lidhje me ankimin e _____

_____ kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Pranimin e ankimeve të, , përkatësisht me nr. 330 prot, nr. 331 prot, nr. 333 prot, datë 16.02.2017, nr.383 prot, datë 24.02.2017, nr. 446 prot, nr. 448 prot, nr. 449 prot, nr. 450 prot, datë 10.03.2017 kundër Autoritetit Publik "Bashkia Berat", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik "Bashkia Berat", për vënien në dispozicion të ankuesve të informacionit sipas kërkesave për informim, brenda datës 27. 4 .2017
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 19. 4 .2017.

